

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë MISIONI NË KOSOVË

Qasja në regjistrim civil në Kosovë

Korrik, 2012

Mohim përgjegjësie:

Versioni i këtij publikimi në gjuhën angleze është versioni zyrtar. Gjitha versionet e këtij publikimi në gjuhët tjera janë përkthim nga versioni origjinal në anglisht, si dhe nuk janë dokumente zyrtare.

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
2. KORINZA LIGJORE DHE E POLITIKAVE.....	6
3. ZHVILLIMET KRYESORE DHE PËRPARIMI MË I MADH NË FUSHËN E REGJISTRIMIT CIVIL	8
4. PENGESAT DHE VËSHTIRËSITË NË FUSHËN E REGJISTRIMIT CIVIL	9
4.1. Burimet e pamjaftueshme financiare, njerëzore dhe logjistike.....	9
4.2. Mosrespektimi i ligjit për gjuhët dhe analfabetizmi.....	10
4.3. Mungesa e vetëdijesimit publik për procedurat dhe përfitimet e regjistrimit.....	11
4.4. Dështimi për të siguruar regjistrimin e fëmijëve që lindin jashtë sistemit shëndetësor	12
4.5. Tarifat e papërballueshme të regjistrimit.....	14
4.6. Udhëzimet dhe procedurat e papërshtatshme për kërkesat që nuk dokumentohen	15
4.7. Distanca, brengat e sigurisë, si dhe kushtëzimi i dokumenteve me pagesë të tatimeve pronësore	17
5. PËRFUNDIME	17
6. REKOMANDIMET.....	19

LISTË E SHKURTESAVE

UA	Udhëzim Administrativ
ARC	Agjencia e Regjistrimit Civil
PDCK	Programi i të Drejtave Civile në Kosovë
ZKRC	Zyra komunale e regjistrimit civil
ZKGjC	Zyra komunale e gjendjes civile
NjKDNj	Njësia komunale për të drejta të njeriut
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MAPL	Ministria për Administrimin e Pushtetit Lokal
ZKKK	Zyra komunale për komunitete dhe kthim
ZKBGj	Zyrtar komunal për barazi gjinore
MiM	Memorandum i mirëkuptimit
OJQ	Organizatë joqeveritare
OSBE	Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
UNHCR	Komisionari i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuar për Fëmijë

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Të njihesh si person para ligjit është e drejtë themelore. Regjistrimi civil është proces përmes së cilit personi identifikohet dhe njihet si pjesë integrale e shoqërisë ku ai/ajo jeton. Personat që nuk janë të regjistruar nuk kanë mundësi të pajisen me dokumente zyrtare dhe si rezultat i kësaj nuk kanë mundësi t'i ushtrojnë të drejtat dhe liritë e tyre. Në Kosovë, anëtarët e komuniteteve ende përballen me vështirësi për t'u regjistruar, prandaj dhe mbesin pa dokumente të identifikimit personal. Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) ka monitoruar procesin e regjistrimit civil dhe ka shqyrtuar progresin dhe mangësitë e institucioneve të Kosovës për të siguruar qasje në regjistrim civil për komunitetet, të cilat janë pakicë numerike në komuna të caktuara duke mbuluar periudhë kohore janar 2010 – tetor 2011.

Ndonëse është rritur numri i zyrave të regjistrimit civil, burimet e pamjaftueshme financiare, logjistike dhe njerëzore e kufizojnë funksionimin e duhur të tyre. Institucionet relevante nuk kryejnë aktivitete të mjaftueshme të informimit dhe ngritjes së vetëdijes në popullatë për ta informuar atë për rëndësinë për procedurat lidhur me regjistrimin civil dhe rëndësinë e tyre.

Në nivel lokal, komunitetet të cila përbëjnë pakicë numerike në një komunë shpesh nuk janë në gjendje të komunikojnë me zyrtarë të regjistrimit civil dhe të marrin dokumente në gjuhën e tyre, meqë shërbyesit civil zakonisht flasin vetëm gjuhën e komunitetit shumicë që jeton në atë komunë.

Për më tepër, tarifat për dokumentet e regjistrimit civil nuk janë të përballueshme për pjesën më të varfër të popullatës. Shumë duhet të bëhet për të lehtësuar regjistrimin e aplikantëve të padokumentuar, meqë zyrtarët e regjistrimit civil e kanë mjaftë vështirë të merren me raste të ndërlikuara në mungesë të udhëzimit nga niveli qendror dhe qasjes uniforme. Brengë e veçantë është praktika e vendosur e paligjshme e kushtëzimit të lëshimit të dokumenteve të regjistrimit civil me pagesën e taksave pronësore në disa komuna.

Për të sjellë procesin e regjistrimit civil në pajtim me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe kërkesat ligjore në Kosovë duhet të ndërmerren disa masa nga institucionet relevante. Institucionet e nivelit qendror dhe atij lokal duhet të ndajnë resurse adekuate financiare, logjistike dhe njerëzore për të përmirësuar funksionimin e zyrave të regjistrimit civil, si dhe kapacitetet e tyre për të arritur te zonat rurale dhe për të siguruar shërbime në të gjitha gjuhët zyrtare. Zyrtarët komunalë të regjistrimit civil duhet të trajnohen për të gjitha procedurat e nevojshme për regjistrimin e lindjeve dhe për regjistrimin e aplikantëve të padokumentuar. Institucionet relevante duhet gjithashtu të sigurojnë përballueshmërinë e tarifave përmes kriterëve të definuar qartë të lirimit nga pagesa dhe duhet të vazhdojnë praktikën e një muaji në vit gjatë të cilit regjistrimi është pa pagesë, ashtu siç është paraparë në Strategjinë për integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian 2009–2015, dhe Planin e saj të veprimit. Në fund, institucionet komunale duhet të përmbahen nga praktika e paligjshme e kushtëzimit të lëshimit të dokumenteve civile me pagesën e tatimit në pronë.

1. HYRJE

Standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut¹ e mbrojnë të drejtën e çdo individi për t'u njohur si person para ligjit², që të regjistrohet menjëherë pas lindjes, të ketë emër dhe të fitojë shtetësi³. Në nivel ndërkombëtar, njohja e personit para ligjit varet nga regjistrimi i personit në regjistrat e shtetit dhe është thelbësore për realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave tjera pa diskriminim⁴. Korniza legjislative në Kosovë i përkufizon komunitetet dhe të drejtat e tyre speciale përkritazi me identitetin, duke i përcaktuar masat që duhet të ndërmerren nga institucionet e Kosovës për të siguruar barazi efektive sa i përket respektimit të një sërë të drejtash.⁵

Me mandat, mes tjerash, për të monitoruar dhe promovuar mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve në Kosovë, OSBE avokon dhe promovon përfshirjen e anëtarëve në pozitë më të pafavorshme të popullsisë. Në pajtim me këtë mandat, ky raport fokusohet në të drejtën për qasje në regjistrim civil për komunitete të cilat janë pakicë numerike në një komunë të caktuar vis-à-vis implementimit të politikave dhe masave të parapara në disa dokumente ligjore dhe të politikave në Kosovë. Ky raport e pason pjesërisht një vlerësim të mëhershëm të OSBE-së që fokusohet në komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës⁶, të cilat janë në mesin e komuniteteve më të cenueshme në Kosovë dhe të cilat janë përballur historikisht me probleme të shoqëruara me mungesë të dokumenteve personale.⁷ Qëllimi i këtij raporti është që të sigurojë një vlerësim më gjithëpërfshirës të qasjes në regjistrim civil për të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë.

Raporti bazohet në monitorime të rregullta në terren, si dhe në intervistat e kryera nga OSBE-ja në komunat e Kosovës nga korriku e deri në tetor 2011. Në nivel komunal, OSBE i ka

¹ Kosova është duke zbatuar një numër të konventave ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe e ka paraparë epërsinë e tyre ndaj dispozitave të tjera të ligjeve dhe akteve administrative.

² Shih nenin 6, Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, 10 dhjetor 1948. Shih gjithashtu nenin 16, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, rezoluta 2200 (XXI) e 16 dhjetorit 1966 e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.

³ Shih neni 24(2), Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Politike dhe Civile, po aty. Gjithashtu, nenet 7 dhe 24, e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, rezoluta 44/25 e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, 20 nëntor 1989. Me rëndësi të veçantë për të drejtat e fëmijës, shih: Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Komenti i Përgjithshëm Nr. 17, Të drejtat e fëmijës, neni 24, 07/04/1989, paragrafi 7 [http://www.unhchr.ch/tbs/doc.nsf/\(Symbol\)/cc0f1f8c391478b7c12563ed004b35e3?Opendocument](http://www.unhchr.ch/tbs/doc.nsf/(Symbol)/cc0f1f8c391478b7c12563ed004b35e3?Opendocument) (qasur më 28 shkurt 2012).

⁴ Për lidhjen ndërmjet të drejtës për t'u njohur para ligjit dhe parimit të përgjithshëm të mosdiskriminimit shih: Komisioni për të Drejtat e Njeriut, CCPR/C/21/Rev.1/Add.10, Koment i Përgjithshëm Nr. 28, 29/03/2000, paragrafi 19. [http://www.unhchr.ch/tbs/doc.nsf/\(Symbol\)/13b02776122d4838802568b900360e80?Opendocument](http://www.unhchr.ch/tbs/doc.nsf/(Symbol)/13b02776122d4838802568b900360e80?Opendocument) (qasur më 28 shkurt 2012).

⁵ Legjislacioni me të cilin mbrohen të drejtat e komuniteteve në Kosovë është mjaftë i gjerë, në mesin e të cilit më i rëndësishmi është Ligji Nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Anëtarëve të tyre në Kosovë, 4 qershor 2008. Megjithatë, është arritur progres i kufizuar në zbatimin e tërë kornizës legjislative për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve në Kosovë.

⁶ Raporti i OSBE *Regjistrimi Civil i Komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian*, janar 2007, <http://www.osce.org/kosovo/25844> (qasur më 28 shkurt 2012).

⁷ Institucionet e Kosovës dhe organizatat ndërkombëtare llogarisin se deri 40 për qind e anëtarëve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian që jetojnë në Kosovë nuk janë të regjistruar si banorë dhe nuk kanë dokumente personale, duke përfshirë këtu pasaportat dhe letërnjoftimet. Shih: 'Human Rights Watch', *Të drejtat e zhvendosura, Kthimet me Forcë të Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve nga Evropa perëndimore në Kosovë*, tetor 2010, f. 41. <http://www.hrw.org/reports/2010/10/28/rights-displaced> (qasur më 28 shkurt 2012).

intervistuar përfaqësuesit e institucioneve që janë direkt përgjegjëse për zbatimin e politikave dhe procedurave të regjistrimit dhe lëshimin e dokumenteve civile.⁸ Informacione shtesë u mblodhën nga zyrtarë të tjerë komunalë përgjegjës për komunitetet që janë pakicë numerike në komuna të caktuara dhe për riintegrimin e të kthyerve⁹, në veçanti nga zyrtarë komunalë për kthim dhe riintegrim (ZKKK)¹⁰. Vlerësimi gjithashtu përfshiu intervista me përfaqësues të të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë,¹¹ organizata joqeveritare lokale (OJQ), si dhe përfaqësues lokalë të Zyrës së Komisionarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR) dhe partnerin e saj zbatues, Programin për të Drejtat Civile/ Kosovë (PDCK).¹² Në nivel qendror, intervistat janë bërë me Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB) dhe Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL). Raporti bazohet në kombinimin e analizave sasiore, cilësore, dhe përshkruese të informatave të mbledhura.

Në fillim raporti ofron një përvijim të kornizës ligjore dhe të politikave që synon rregullimin dhe lehtësimin procesin e regjistrimit civil në Kosovë. Më pas, raporti vlerëson zbatimin e obligimeve të institucioneve qendrore dhe lokale për të siguruar regjistrimin civil të grupeve më të cenueshme, në veçanti komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. Përfundimisht, raporti përfundon duke paraqitur rekomandime, qëllimi i të cilave është përmirësimi i përgjigjeve komunale për t'i trajtuar pengesat kryesore të cilat ende e sfidojnë procesin e regjistrimit civil.

2. KORINZA LIGJORE DHE E POLITIKAVE

Në Kosovës, ka dy lloje të regjistrimit civil: a) regjistrimi i gjendjes civile lidhur me regjistrimin e fakteve të gjendjes civile të një personi, siç është lindja, martesja dhe vdekja.¹³; dhe b) regjistrimi civil lidhur me lëshimin e dokumenteve të identifikimit dhe të udhëtimit (letërnjoftimi, pasaporta dhe patentë shoferi)¹⁴. MPB është përgjegjëse për zhvillimin,

⁸ Gjithsej 33 zyra të gjendjes civile, 27 zyra komunale të regjistrimit civil dhe drejtorët e pesë departamenteve komunale të administratës së përgjithshme.

⁹ Gjithsej 27 zyrtarë komunalë për barazi gjinore, 26 zyra komunale për komunitete dhe kthim, tre zyrtarë komunal për kthim, dy zëvendëskryetar për komunitete, një koordinator i njësishë komunale për të drejta të njeriut.

¹⁰ ZKKK themelohet sipas Ligjit nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, 15 qershor 2008, dhe Ligjin për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe anëtarëve të tyre në Kosovë, shënim 5, *sipër*. Aty ku ZKKK-të nuk janë themeluar, zyrtarët komunalë për kthim ose kryesuesit e zyrave komunale për kthim janë intervistuar për qëllim të këtij raporti.

¹¹ Të intervistuarit u përzgjedhën në bazë të funksioneve të tyre (udhëheqës të zgjedhur të fshatit/komunitetit, udhëheqësi komunal, punonjës komunal ose anëtarë të komiteteve komunale, anëtarë aktivë të shoqërisë civile ose organizatave joqeveritare). Gjithashtu, disa individë janë intervistuar bazuar në vështirësitë e përjetuara gjatë procedurës së regjistrimit civil.

¹² OJQ-ja lokale PDCK ka qenë partner implementues i UNHCR-së që nga viti 2006, kur ky i fundit ka lansuar Planin e tij të Veprimit për fushatën e regjistrimit civil që i ka pasur për cak komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë.

¹³ Ligji nr. 04/L-003 për Gjendjen civile, 8 korrik 2011. Më parë çështja ishte e rregulluar përmes Ligjit nr. 2004/46 mbi regjistrat e gjendjes civile, shpallur me Rregullore të UNMIK-ut Nr. 2005/21, 7 maj 2005 dhe Ligji Nr. 02/L-126 mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi regjistrat e gjendjes civile nr. 2004/46, 27 shtator 2007.

¹⁴ Në mesin e legjislacionit relevant: Ligji Nr. 03/L-099 për letërnjoftimin, 13 tetor 2008; Ligji Nr. 03/L-037 për dokumentet e udhëtimit, 15 qershor 2008; 15 qershor 2008; Ligji Nr. 02/L-118 për emrin personal, i shpallur me Rregullore të UNMIK-ut 2008/11, 22 shkurt 2008; Ligji Nr. 2004/32 për familjen, ashtu siç është shpallur me Rregullore të UNMIK-ut 2006/7, 16 shkurt 2006.

implementimin, organizimin dhe mbikëqyrjen e politikave të regjistrimit civil dhe regjistrimit të gjendjes civile përmes Agjencisë për Regjistrim Civil (ARC).¹⁵

Në nivel komunal, regjistrimi civil kryhet nga zyrat komunale të regjistrimit civil (ZKRC), të cilat funksionojnë në kuadër të MPB-së dhe janë përgjegjëse për lëshimin e dokumenteve të udhëtimit dhe letërnjoftimeve¹⁶ Si kompetencë e deleguar¹⁷, shërbimet lidhur me gjendjen civile në nivel lokal zbatohen nga zyrat komunale për gjendjen civile (ZKGJC), të cilat janë përgjegjëse për lëshimin e numrave personal të identifikimit, si dhe certifikatat e lindjes, ato familjare, të martesës dhe të vdekjes.¹⁸ ZKGJC-të themelohen me statute komunale dhe organizimi dhe mbështetja financiare varen nga drejtoritë komunale të administratës së përgjithshme, ndonëse ato punojnë në bashkëpunim dhe nën monitorim dhe mbikëqyrje të MPB-së.¹⁹

Përmes miratimit të Strategjisë për Integrimin e Komunitetit Rom, Ashkali, Egjiptian²⁰ në dhjetor 2008 dhe Planin e Veprimit²¹ për zbatimin e saj në dhjetor 2009, institucionet e Kosovës janë zotuar për të lehtësuar regjistrimin e anëtarëve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. Këto dy instrumente të politikave e nxisin MPB-në që, në bashkëpunim me ministritë tjera relevante²² dhe komunat, t'i zëvendësojnë procedurat standarde me procedura më fleksibile afatmesme për të siguruar regjistrimin e këtyre komuniteteve të cënueshme.²³

Masat lehtësuese për regjistrimin civil gjithashtu parashihen edhe në Doracakun e Rishikuar për Kthim të Qëndrueshëm²⁴, si dhe në Strategjinë e Rishikuar për Riintegrimin e Personave

¹⁵ ARC u themelua me Udhëzim Administrativ (UA) Nr. 17/2010 mbi organizimin dhe strukturimin e Agjencisë për Regjistrim Civil, 7 shtator 2010 dhe funksionon si agjenci ekzekutive në kuadër të MPB-së. Ajo është përgjegjëse për regjistrimin qendror të gjendjes civile, ku përmbahen informacione të gjendjes civile për të gjithë banorët e Kosovës, shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi, me qëndrim të përkohshëm ose të përhershëm në Kosovë, si dhe shtetasit e huaj të cilëve u është dhënë azil në Kosovë. Shih, Ligji për gjendjen civile, shënim 13, sipër, neni 26.

¹⁶ Puna e ZKKK bazohet në Ligjin për letërnjoftimin dhe Ligjin për dokumentet e udhëtimit, shënim 14, sipër.

¹⁷ Ligji për gjendjen civile, shënim 13, sipër, neni 56.

¹⁸ Po aty. Neni 59. ZKGJC-të gjithashtu kanë përgjegjësi për përditësimin e regjistrit qendror të gjendjes civile dhe mbajtjen e akteve të lindjes, martesës dhe vdekjes.

¹⁹ Shih shënim 16 sipër, neni 10.

²⁰ Zyra e Kryeministrit, *Strategjia për integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, 2009–2015*, dhjetor 2008; http://www.kryeministri-ks.net/zck/repository/docs/Strategy_for_the_Integration_of_Roma_Ashkali_and_Egyptian_communities_2009-2015.pdf (qasur më 28 shkurt 2012).

²¹ Zyra e Kryeministrit, *Plani i Veprimit i Kosovës për implementimin e Strategjisë për integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian 2009–2015*, dhjetor 2009; http://www.kryeministri-ks.net/zck/repository/docs/Action_Plan_on_the_Implementation_of_the_Strategy_for_the_Integration_of_Roma_Ashkali_and_Egyptian_Communities_2009-2015.pdf (qasur më 28 shkurt 2012).

²² MAPL, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Shëndetësisë, si dhe Zyra për çështje të komuniteteve dhe Zyra për qeverisje të mirë në kuadër të zyrës së kryeministrit. .

²³ Shih *Strategjia për integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, shënim 21, sipër, Kapitulli 2.7*.

²⁴ Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë/Institucionet e Përkohshme të vetëqeverisjes *Doracku i Rishikuar për Kthim të Qëndrueshëm*, korrik 2006. Shtojca e tij 1, seksioni 3 (C) thekson: “[...] Duke pasur parasysh numrin e madh të kërkesave për dokumentacionin e regjistrimit civil, komunat janë udhëzuar që të sigurojnë që kërkesat e mbetura pezull për regjistrim për romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët të përfundojnë gjatë gjashtë muajve të ardhshëm. Nuk do të zbatohen taksa për vonesë për këto shërbime administrative për këto grupe”.

të Riatdhesuar²⁵ dhe Planin e saj të Veprimit²⁶. Gjithashtu, legjislacioni në Kosovë është fleksibil lidhur me dëshmitë që përcaktojnë identitetin dhe të drejtën e aplikantit.²⁷

3. ZHVILLIMET KRYESORE DHE PËRPARIMI NË FUSHËN E REGJISTRIMIT CIVIL

Në intervistën e realizuar nga OSBE-ja, MPB²⁸ i theksoi hapat e ndërmarrë në bashkëpunim me bashkësinë ndërkombëtare për përmirësimin e shërbimeve të regjistrimit civil, siç janë përmirësimi i funksionimit të sistemit të adresave në Kosovë²⁹, konsolidimit të regjistrave civil³⁰ dhe digjitalizimit të të dhënave. Sipas MPB-së, numri i ZKGJC-ve dhe ZKRC-ve dhe nënzyrave përkatëse është në rritje e sipër, me qëllim të mbulimit të të gjitha komunave në Kosovë³¹. Gjithashtu, ligji i miratuar kohëve të fundit për gjendjen civile³² e ka përmirësuar kornizën ligjore për regjistrimin dhe lëshimin e dokumenteve të gjendjes civile, duke mbuluar personat që janë me banim të përhershëm dhe të përkohshëm në Kosovë, si dhe ata që jetojnë jashtë vendit. Ai gjithashtu rregullon boshllëqet në fushat e regjistrimit të serishëm dhe regjistrimit të vonshëm³³.

Në anën tjetër, në përpjekje për t'i laruar pengesat përkitazi me regjistrimin civil dhe në pajtim me Planin e Veprimit për Zbatimin e Strategjisë për integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian³⁴, në vitin 2010 MAPL shpalli muajin prill si muajin e regjistrimit pa pagesë për pjesëtarët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian.

²⁵ Qeveria e Kosovës, *Strategjia e Ndryshuar për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar*, maj 2010, <http://www.mpb-ks.org/repository/docs/Strategjia%20per%20Riintegrimin%20e%20personave%20te%20Riatdhesuarenglish.pdf> (qasur më 28 shkurt 2012).

²⁶ Qeveria e Kosovës, *Plani i Veprimit për Zbatimin e Strategjisë së Ndryshuar për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar*, gusht 2010. http://www.mpb-ks.org/repository/docs/PLANI_I_VEPRIMIT_I_MODIFIKUAR_final%2027%20shtator%202010.pdf (qasur më 28 shkurt 2012).

²⁷ Udhëzim Administrativ i MPB-së nr. 05/2009 për Kërkesat që Përbëjnë Dëshmi të Shtetësisë së Ish Republikës Federative të Jugosllavisë dhe Banimit të Përhershëm në Territorin e Kosovës më 1 janar 1998, 3 mars 2009, neni 4.2.

²⁸ Intervistë e OSBE-së me Drejtorin e Departamentit të Regjistrimit dhe Gjendjes Civile, ARC, 11 gusht 2011, Ndërtesa e ARC-së në Prishtinë.

²⁹ Projekt i BE-së për Mbështetjen e Agjencisë së Regjistrimit Civil dhe Sistemin e Unifikuar të Adresave, e-buletini, nëntor 2011, nr. 1. http://www.change4kosovo.com/data/Ressources/5_3-the_newsletter.pdf (e qasur më 28 shkurt 2012).

³⁰ Në kuadër të dialogut ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, të udhëhequr nga BE-ja, për çështje teknike, në korrik të vitit 2011 dy palët kanë arritur marrëveshje për librat e regjistrimit civil. Me lehtësimin e misionit për sundim të ligjit në Kosovë (EULEX), procesi i konsolidimit të librave të regjistrimit civil në Kosovë përbëhet nga skenimi, fotokopjimi dhe certifikimi i të gjitha librave origjinale të gjendjes civile në dispozicion (më shumë se 14,000). Pas kësaj, pritet që ARC t'i konsolidojë të dhënat në mënyrë që të arrihet në një regjistër të besueshëm të gjendjes civile në Kosovë.

³¹ Që nga tetori 2011, gjithsej 31 ZKRC dhe 33 ZKGJC dhe 140 zyra mobile janë numëruar në mbarë Kosovën. Shih e-buletinin, shënimi 29, *më sipër*.

³² Shih ligjin për Gjendjen Civile, shënimi 13 *më sipër*.

³³ Çështjet e regjistrimit të serishëm dhe regjistrimit të vonshëm janë shpjeguar dhe shtjelluar më poshtë në kapitullin 4.6, shënimi 81, *më poshtë*. Për sa i përket regjistrimit me vonesë më 15 mars 2012 MPB ka lëshuar qarkoren nr. 123 për lirim të komuniteteve romë shkali dhe egjiptian të Kosovës nga pagesa e tarifës së regjistrimit të lindjeve dhe vdekjeve për një periudhë deri në një vit.

³⁴ Shih *Planin Kosovar të veprimit për zbatimin e Strategjisë për integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian*, shënimi 21, *më sipër*, kapitulli 2.7 Regjistrimi, Objektivi 1, Veprimi 1.2.3. Plani i Veprimit

Gjatë punës monitoruese të OSBE-së në 2011, institucionet e nivelit qendror dhe komunal kanë theksuar aktivitetet e tyre të sensibilizimit publik dhe komunikimit me rajonet e largëta. Duke pranuar që shumica e aktiviteteve të komunikimit me publikun realizohen nga PDCK, disa ZKGJC dhe ZKRC kanë përshkruar bashkëpunimin e tyre proaktiv me këtë OJQ kryesisht të lidhur me shpërndarjen e materialeve informuese (afishe dhe fletëpalosje) te komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian.³⁵ Komunitet tjerë kanë realizuar vetë fushatat e tyre informuese dhe aktivitetet e komunikimit me publikun.³⁶ Gjithashtu, disa komuna kanë raportuar, përmes ZKGJC, ZKRC dhe/apo ZKKK, se kanë ndërmarrë hapa për ta lehtësuar qasjen në regjistrimin civil përmes ekipeve të përkohshme mobile që shërbenin vendbanimet e izoluar apo personat më të cënueshëm, siç janë personat me aftësi të kufizuara apo të hospitalizuar, personat që nuk mund t'i paguajnë shpenzimet e transportit për në zyra, si dhe të kthyerit.³⁷ Po ashtu, disa ZKRC kanë raportuar se janë aktivisht të angazhuar në një fushatë informuese të udhëhequr nga MPB për lëshimin e pasaportave dhe letërnjoftimeve.³⁸

Megjithatë, pavarësisht nga disa hapa dhe përparime konkrete, në mbarë Kosovën pjesëtarët e komuniteteve në pakicë numerike në komuna të caktuara në shumë raste vazhdojnë të mos jenë të regjistruar dhe të mos kenë identifikim personal, gjë që pakëson gëzimin e të drejtave të tyre themelore të njeriut.³⁹ Kapitulli në vijim nënvizon pengesat dhe vështirësitë kryesore që vazhdojnë të jenë të pranishme në fushën e regjistrimit civil, bazuar në informatat plotësuese të mbledhura si nga institucionet e regjistrimit civil ashtu edhe nga përfaqësues të komuniteteve.

4. PENGESAT DHE VËSHTIRËSITË NË FUSHËN E REGJISTRIMIT CIVIL

4.1. Burimet e pamjaftueshme financiare, njerëzore dhe logjistike

Burimet e pamjaftueshme njerëzore si dhe mungesa e hapësirës për zyra dhe e pajisjeve adekuate (siç janë makinat për fotokopje, kompjuterët, kabinetet për dosje dhe zyrat e arkivit) janë raportuar në tetë komuna nga zyrtarët e intervistuar.⁴⁰ ZKGJC në komunat e

udhëzon se “të gjitha komunat që një herë në vit shpallin muajin e regjistrimit civil pa pagesë për personat e paregjistruar dhe fëmijët e lindur jashtë sistemit shëndetësor”.

³⁵ Komunitet tjerë në Kosovë/Kosovo Polje dhe Gračanica/Gračanicë janë cekur si shembuj pozitiv të bashkëpunimit nga ane e Drejtorit Rajonal PDCK-së në rajonin e Prishtinës/Priştina gjatë intervistës së mbajtur më 20 qershor 2011.

³⁶ Për shembull, në komunën e Gjakovës/Đakovica ZKRC ka ngritur vetëdijen për regjistrimin civil përmes radiostacionit lokal “Gjakovë” dhe TV “Syri”, gjersa ZKGJC në komunën e Klinës/Klina ka ndërmarrë hapa konkret për të lehtësuar qasjen në regjistrimin civil përmes një fushate informuese në Radio “Alba”. Në komunën e Klinës/Klina ZKRC ka organizuar fushata të ngritjes së vetëdijes dy herë në vit me fletëpalosje dhe broshura, si dhe fushata informuese nëpërmjet radios. Në Skenderaj/Srbica, ZKGJC e ka organizuar fushatën përmes një radio programi në vitin 2010.

³⁷ Komunitet Ferizaj/Uroševac, Gjakovë/Đakovica, Gjiilan/Gnjilane, Istog/Istok, Klinë/Klina, Lipjan/Lipljan, Obiliq/Obilić, Rahovec/Orahovac dhe Vushtrri/Vučitrn. Në disa raste, ekipet mobile kanë kryer regjistrimin në vend, në disa të tjera kanë ofruar transportim për aplikuesit, gjersa në rastet tjera ata kanë grumbulluar dhe kanë kthyer dokumente.

³⁸ Komunitet Deçan/Dečane, Klinë/Klina, Novo Brdo/Novobërdë dhe Pejë/Peć.

³⁹ Për shembull, mungesa e dokumentacionit në kohën e regjistrimit në shkollë është një nga pengesat kryesore për shqyrtim përfshirës. Gjithashtu, mungesa e dokumentacionit është pengesë në qasjen në kujdes shëndetësor dhe në përfitime sociale.

⁴⁰ Çështjet e raportuara nga ZKGJC-të dhe ZKRC-të nga komunat e Deçanit/Dečane, Obiliqit/Obilić, Prizrenit, Vushtrrisë/Vučitrn dhe ZKGJC në Dragash/Dragaš, Istog/Istok, Shtime/Štimlje dhe Viti/Vitina.

Deçanit/Deçane, Klinës/Klina dhe Prishtinës/Priština po ashtu kanë hasur në vështirësi lidhur me mungesën e mirëmbajtjes së rregullt të kompjuterëve, mungesën e lidhjeve në internet, kompjuterët të vjetër, si dhe probleme të shumta teknike gjatë futjes së të dhënave për personat e regjistruar për herë të parë.

Mungesa e stafit në shumë komuna të Kosovës është problem tjetër që ndikon në funksionimin e duhur të ZKRC dhe ZKGJC⁴¹, përfshirë këtu mundësitë e tyre për t'iu qasur rajoneve të largëta. Megjithatë, ky problem nuk është trajtuar në mënyrë të qëndrueshme, dhe numri i stafit rritet vetëm gjatë periudhës së verës për t'i akomoduar kërkesat shtesë të shërbimeve të regjistrimit civil të diasporës së kthyer në vend.⁴²

4.2. Mosrespektimi i ligjit për gjuhët dhe analfabetizmi

Gjithashtu, qasja në regjistrimin civil varet edhe nga respektimi i gjuhëve⁴³ dhe kërkon që institucionet komunale të sigurojnë ofrimin e shërbimeve në gjuhët zyrtare, drejtpërsëdrejti përmes shërbyesve civil apo përmes asistencës gjuhësore. Përkundër këtij obligimi, disa ZKKK kanë raportuar vështirësi me të cilat janë përballë pjesëtarët e komuniteteve joshqiptare, meqë komunikimi në ZKGJC dhe ZKRC bëhet ose vetëm në shqip ose në shqip dhe në një serbishte të dobët. Disa nga komunat që kanë raportuar probleme të tilla janë Gjilani/Gnjilane, Mitrovicë/Mitrovica, Novo Brdo/Novobërda dhe Vitia/Vitina, gjersa kjo e fundit i shpallë të gjitha njoftimet publike në ZKGJC dhe ZKRC vetëm në gjuhën shqipe. Ngjashëm me këtë, problemet gjuhësore janë raportuar nga komuniteti shqiptar në komunën e Graçanicës/Graçanicës, ku mungesa e punonjësve që flasin shqip apo përkthejnë në shqip e pengon komunikimin me popullatën shqiptare të Kosovës.

Veç kësaj, janë raportuar edhe pengesa lidhur me shkrim-leximin, si për shembull në komunën e Gjakovës/Đakovica, në të cilën pjesëtarët e komunitetit rom përballen me vështirësi në plotësimin e saktë të formularëve të regjistrimit civil. Një gjë e tillë, pasqyron situatën e përgjithshme të marginalizimit të cilën e vuajnë në veçanti komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian, të cilët përballen me pengesat më komplekse në kuptim të përfshirjes në arsimim⁴⁴ përkundër obligimeve qeveritare⁴⁵ për të marrë masa konkrete për t'i larguar ato.

⁴¹ ZKGJC në komunën e Deçanit/Deçane, ZKGJC dhe ZKRC në komunën e Prizrenit, ZKRC në Obiliq/Obilić, ZKGJC në Shtime/Štimlje dhe ZKRC në Vushtri/Vučitrn; zyrat e bashkësisë komunale të udhëhequra nga Prishtina në komunat veriore të Leposavić/Leposaviqit, Zubin Potokut, Zvečan/Zveçanit, të cilat gjenden në fshatrat e banuara vetëm me shqiptarë, dhe zyrën e regjistrimit civil në Mitrovica/Mitrovicën veriore e cila gjendet në Lagjen e Boshnjakëve, lagje e banuar nga shqiptarë, serbë, boshnjakë, turq, romë të Kosovës dhe të tjerë.

⁴² ZKGJC dhe ZKRC-të në komunat e Deçanit/Deçane, Dragashit/Dragaš, Klinës/Klina, Obiliqit/Obilić, Pejës/Peć dhe Prizrenit kanë raportuar se kanë aplikuar orar të zgjatur të punës apo kanë angazhuar punonjës shtesë (shpeshherë praktikantë) gjatë periudhës së verës.

⁴³ Neni 7.2 i ligjit nr. 02/L-37 për Përdorimin e gjuhëve, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/51, 20 tetor 2006, përcakton se “Çdo person ka të drejtë të komunikoj dhe të pranojë shërbimet e mundshme dhe dokumentet publike nga institucionet komunale dhe nga zyrtarët në cilëndo gjuhë zyrtare. Çdo organ përfaqësues dhe ekzekutiv komunal ka për detyrë të sigurojë që çdo person të mund të komunikojë dhe të pranojë shërbimet në dispozicion dhe dokumentet publike nga çdo institucion dhe organ komunal në cilëndo gjuhë zyrtare”.

⁴⁴ Fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë të Kosovës qëndrojnë në shkolla për periudhë më të shkurtër kohore krahasuar me anëtarët e komuniteteve tjera në Kosovë. Si rrjedhojë, më shumë se 16 për qind e pjesëtarëve të këtyre tre komuniteteve nuk dinë shkrim dhe lexim. Shih: Programi i OKB-së për Zhvillim, *Raport për Zhvillimin Njerëzor në Kosovë 2010*, f. 59, <http://www.ks.undp.org/repository/docs/HDR-2010-English.pdf> (qasur më 28 shkurt 2012).

4.3. Mungesa e vetëdijesimit publik për procedurat dhe përfitimet e regjistrimit

Në vitin 2009, gjetjet e raportit të Fondit të OKB-së për Fëmijë (UNICEF) kanë zbuluar se 8.3 për qind e ekonomive familjare të Kosovës nuk i kanë regjistruar në lindje së paku disa nga fëmijët e tyre nën moshën 18 vjeçare.⁴⁵ Sipas raportit, nga të gjithë banorët e Kosovës, gjasat më të mëdha të mosregjistrimit të lindjeve të fëmijëve janë me komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian, vijuar nga komuniteti shqiptar dhe turk. Arsyeja më e rëndomtë për mosregjistrim të lindjeve në Kosovë ishte mungesa e njohurisë për përparësitë e regjistrimit dhe të metat e mosregjistrimit, vijuar nga mungesa e dokumentacionit të nevojshëm nga ana e prindërve për t'i regjistruar fëmijët e tyre, si dhe mungesa e lidhur me procedurat e regjistrimit të lindjes.

Gjatë intervistave, vetëm disa përfaqësues të komuniteteve joshumicë kanë shfaqur kuptim të mirë për rëndësinë dhe përfitimet nga posedimi i dokumenteve personale, për shembull për qasjen në arsim, punësim apo për udhëtim.⁴⁷ Ende ka raste të anëtarëve të komunitetit (kryesisht të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian⁴⁸) të cilët nuk dinë rëndësinë, procedurat dhe shpenzimet e regjistrimit civil dhe i regjistrojnë fëmijët e tyre vetëm kur u nevojiten dokumente të regjistrimit civil kosovar për të aplikuar për ndihma sociale apo për t'i regjistruar fëmijët e tyre në shkollë. Kjo mungesë e përgjithshme e vetëdijesimit është theksuar në komunën e Deçanit nga personat e zhvendosur brenda vendit të komunitetit serb dhe malazez të Kosovës. Në veçanti, shumica e të anketuarve⁴⁹ që nuk ishin tërësisht të familjarizuar me procedurat për marrjen e dokumenteve personale kanë raportuar se mbështeten në PDCK-në, të cilat i dorëzojnë të gjitha dokumentet për kryerjen e regjistrimit civil.

Shumica e zyrtarëve komunal nuk kanë raportuar për ndonjë nevojë për aktivitete shitesë të komunikimit me publikun, duke thënë se komunitetet janë tërësisht të vetëdijshme për procesin e regjistrimit civil, ndonëse një gjë e tillë nuk është pasqyruar gjithmonë në gjendjen e përshkruar nga vetë komunitetet. Gjatë intervistave, disa pjesëtarë të komuniteteve joshqiptare nga komuna të ndryshme⁵⁰ kanë theksuar nevojën për të komunikuar me fshatrat dhe vendbanimet joformale. Në komunën e Lipjanit/Lipljane, kërkesa për më shumë informata dhe mbështetje e cekur nga përfaqësuesit e intervistuar të komunitetit ashkali ishte në kundërshtim me deklaratën pozitive të dhënë nga institucionet lokale të cilat nuk kishin

⁴⁵ “Të gjithë personat që iu përkasin komuniteteve kanë të drejtë të marrin shkollim publik në të gjitha nivelet, në njërin nga gjuhët zyrtare të Kosovës.” Shih ligjin për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Kosovë, shënimi 5, *më sipër*, neni 8.1.

⁴⁶ Shih raportin e UNICEF, *Regjistrimi i Lindjeve në Kosovë*, mars 2009, p. 9, http://www.unicef.org/kosovo/UNICEF_Birth_Registration_2009_English.pdf (qasur më 28 shkurt 2012).

⁴⁷ Përfaqësues të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës nga komunat Malishevë/Mališevo, Shtime/Štimlje, Suharekë/Suva Reka, Pejë/Peć, Deçan/Dečane, Gračanica/Gračanicë, Mitrovicë/Mitrovica; Goranë dhe boshnjakë të Kosovës në komunat Dragash/Dragaš; përfaqësues serbë të Kosovës nga komunat Rahovec/Orahovac, Skenderaj/Srbica, Vushtri/Vučitrn dhe Istog/Istok.

⁴⁸ Intervistë me përfaqësues ashkali në komunën e Lipjanit dhe romë, ashkali dhe egjiptianë në komunën e Fushë Kosovës.

⁴⁹ Serbë të Kosovës në komunat Skenderaj/Srbica, Vushtri/Vučitrn dhe Ferizaj/Uroševac, liderë egjiptianë në komunën e Istogut, përfaqësues Ashkali në Lipjan/Lipljane dhe Prishtinë/Priština, romë dhe ashkali në Obiliq/Obilić dhe Ferizaj/Uroševac, serbë dhe malazezë të zhvendosur në Deçan/Dečane.

⁵⁰ Përfaqësues egjiptianë dhe boshnjakë nga komuna e Istogut/Istok; përfaqësues ashkali nga komuna Lipjan/Lipljan; përfaqësues romë dhe ashkali nga komuna e Ferizajt/Uroševac; romë, ashkali dhe egjiptianë nga komuna Obiliq/Obilić; përfaqësues të komunitetit serb, rom dhe egjiptianë nga komuna e Klinës.

identifikuar një nevojë të tillë.⁵¹ Sidoqoftë, zyrtarët e tjerë të regjistrimit civil u pajtuan për nevojën e shtimit të sensibilizimit, ekupeve mobile dhe nën-zyrave në shërbim të vendbanimeve rurale.⁵² Disa ZKRC pranuan se ka nevojë që komunat të jenë më të angazhuara dhe që të udhëheqin në veprimtaritë sensibilizuese në vend që thjesht të delegojnë obligimet e tyre tek UNHCR dhe PDCK, duke komentuar se kjo do të ngrit njohuritë e tyre për rastet e veçanta dhe kapacitetin për të adresuar nevojat e identifikuara.

4.4. Dështimi për të siguruar regjistrimin e fëmijëve që lindin jashtë sistemit shëndetësor

Regjistrimi i lindjes, një e drejtë e mishëruar në një gamë të traktateve për të drejtat e njeriut⁵³, është portë që çon në realizimin e të drejtave tjera themelore për shkak se mundëson qasje në shërbimet thelbësore si arsimi dhe shëndetësia.⁵⁴ Plani i veprimit për zbatimin e strategjisë për integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë i bën thirrje institucioneve komunale që, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe qendrat spitalore, t'i ofrojnë popullatës informacion dhe këshillim për regjistrimin e menjëhershëm të foshnjave të porsalindura.⁵⁵ Përveç kësaj, i njëjti dokument i inkurajon zyrtarët komunalë për barazi gjinore (ZKBGJ) që,⁵⁶ në bashkëpunim me OJQ-të, të organizojnë takime me komunitetet për të zvogëluar numrin e foshnjave të paregjistruara të cilat lindin jashtë sistemit shëndetësor, kryesisht të atyre që i përkasin komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë.⁵⁷

⁵¹ ZKRC raportoi se komuna e Lipjanit/Lipljane përdor zyra satelite të ZKRC në fshatrat Babush/Babuš, Janjevë/Janjevo, Magure/Magura, Kraisht/Kraište dhe Shalë/Sedlare (me personelin i cili flet shqip dhe serbisht) për t'i mbuluar vendbanimet rurale dhe prandaj nuk përdor më ekipet mobile (përveç vizitave të personat me aftësi të kufizuara apo të moshuarit). Për më tepër, zyrtari i ZKRC theksoi përshtypjen e tij se mbi 99 përqind e banorëve janë të regjistruar dhe se ka nivel të lartë të respektimit të ligjit, duke konsideruar kështu se fushatat e sensibilizimit nuk janë të nevojshme.

⁵² Veprimtaritë sensibilizuese u rekomanduan shumë nga zyrtarët e regjistrimit të gjendjes civile në komunat Ferizaj/Uroševac, Gračanica/Gračanicë, Istog/Istok, Kamenicë/Kamenica, Klinë/Klina, Shtime/Štimlje, Suharekë/Suva Reka dhe Viti/Vitina. Në komunën e Gjilanit/Gnjilane, ZKRC rekomandoi afrim fizik të ZKRC dhe të ZKGJC për të lehtësuar qasjen e banorëve në ofruesit e shërbimit. Në komunën e Mitrovicës/Mitrovica, u theksua nevoja për të siguruar njoftim më të mirë dhe informacion mbi përfitimet e regjistrimit për ata të cilët jetojnë në veri të Kosovë dhe në mëhallën Rome. Në disa raste, ZKGJC raportoi për nevojën e ekupeve mobile apo nën-zyrave, duke përmendur vështirësitë për të kontaktuar me popullatën për shkak të mungesës së transportit/automjeteve.

⁵³ Shih fusnotën 3 më sipër.

⁵⁴ Shih Komisionin për të drejtat e njeriut, vërejtjet përmbyllëse në lidhje me Bosnje dhe Hercegovinën për të drejtën në shëndetësi dhe arsim si pjesë e regjistrimit të lindjes, UN Doc. CCPR/C/BIH/CO/1 (2006). <http://daccess-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/G06/457/65/PDF/G0645765.pdf?OpenElement> (qasur më 28 shkurt 2012).

⁵⁵ Shih shënimin 22 më sipër, regjistrimi, synimi 1.

⁵⁶ ZKBGJ janë shërbyes civilë në nivel komunal të ngarkuar me detyrën për të punuar në arritjen e barazisë gjinore si dhe të paraqitjes së aspektit gjinor në politikat, legjislacionin dhe praktikat komunale. Kjo pozitë u themelua me anë të UA nr. 2005/08 të MAPL-së për përcaktimin e kompetencave dhe përshkrimin e detyrave të zyrtarëve për barazi gjinore në komuna, e datës 7 dhjetor 2005. ZKBGJ-të u përfshinë në njësitë komunale për të drejtat e njeriut me anë të UA nr. 2011/01 për ndryshimin dhe plotësimin e UA nr. 2008/02 për themelimin e njërive për të drejtat e njeriut në komuna, i datës 29 prill 2011, i cili gjithashtu përshkruan detyrat e tyre të reja të punës.

⁵⁷ Shih shënimin 22 më sipër, kapitulli 2.7, regjistrimi dhe dokumentet: “komunat miratojnë një qasje të ndjeshme ndaj gjinisë që ndihmon nënat dhe foshnjat në rastet e lindjes në shtëpi dhe promovojnë regjistrimin civil të të gjitha foshnjave të porsalindura. Komunat themelojnë një mekanizëm bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve gjegjëse komunale, duke përfshirë autoritetet shëndetësore dhe mamitë, edhe të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë, duke përfshirë gratë nga komunitetet të cilat ndihmojnë lindjen në shtëpi për të parandaluar mosregjistrimin e ardhshëm”.

Sipas intervistave të zhvilluara nga OSBE-ja, në shumicën e rasteve komunat raportuan se kanë një bashkëpunim shumë të mirë me Ministrinë e Shëndetësisë, qendrat spitalore dhe qendrat e mjekësisë familjare, duke iu mundësuar komunave ofrimin e informacionit dhe këshillimit për prindërit për regjistrim të foshnjave të porsalindura. Në veçanti, personeli i ZKGJC raportoi se ata vizitojnë rregullisht spitalet dhe qendrat e mjekësisë familjare dhe se e udhëzojnë personelin mjekësor, i cili drejtpërdrejtë njofton familjet për kriteret ligjore dhe procedurat për regjistrim të foshnjave të porsalindura.⁵⁸ Megjithatë, disa komuna nuk ofrojnë informacion për këtë temë. Zyrtarët komunalë të intervistuar e arsyetuan këtë mbi bazën e asaj se nuk kanë ndonjë spital në komunë (siç janë komuna e Junikut dhe e Fushë Kosovës/Kosovo Polje⁵⁹) ose që të gjithë banorët janë të njoftuar për procedurat e regjistrimit dhe se ata nuk kanë asnjë rast të paregjistruar (siç u raportua në komunën e Dragashit/Drasht⁶⁰). ZKGJC në lagjen “Mëhalla boshnjake” në veri të Mitrovica/Mitrovicës nuk pranon të dhëna për foshnjat e porsalindura, duke qenë se shërbimi i regjistrimit kryhet në jug të Mitrovicës/Mitrovica.

Përkitazi me përfshirjen e ZKBGJ, vetëm ZKBGJ (i cili punon edhe si zyrtar komunal për kthim) në komunën e Gračanica/Graçanicës viziton dhe këshillon prindërit, fëmijët e të cilëve lindin në shtëpi apo jashtë Kosovës. Në këtë rast, ZKBGJ theksoi nevojën për përpjekje të veçanta për të njoftuar komunitetin romë të Kosovës, i cili jeton në komunën e Gračanica/Graçanicës, për rëndësinë e regjistrimit të foshnjave të porsalindura.⁶¹ Në shumicën e rasteve tjera, ZKBGJ-të raportuan se nuk kanë ndërmarr asnjë nismë për të regjistruar fëmijët e lindur jashtë sistemit shëndetësor për shkak se, siç pohojnë ata, nuk ka raste të tilla. Në disa komuna, ZKBGJ-të theksuan se ata asnjëherë nuk kishin qenë të njoftuar për rolin e tyre në çështjet e regjistrimit të foshnjave të porsalindura.⁶² Në Gjakovë/Đakovica, ku shumë pjesëtarë të komunitetit egjiptianë të Kosovës⁶³ po ballafaqohen me probleme në lidhje me regjistrimin civil për shkak të lindjeve në shtëpi, ZKBGJ shprehu mendimin se kjo çështje nuk është kompetencë e tij.

Ndonëse nuk përmendet në Strategjinë për integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë dhe në planin e saj të veprimit, është e rëndësishme të theksohet se ZKBGJ-të janë anëtarë të zyrave komunale për të drejtat e njeriut (ZKDNJ). Këto njësi janë organe përgjegjëse për të vlerësuar dhe siguruar respektimin e politikave, legjislacionit dhe veprimeve të komunës me standardet më të larta të drejtave të njeriut.⁶⁴ Mungesa e përgjithshme e bashkëpunimit ndërmjet ZKDNJ dhe aktorëve tjerë gjegjë, për shembull me ZKKK, u theksua nga ZKBGJ në komunën e Gjilanit/Gnjilane dhe atë të Klinës/Klina si arsye për mospunën e tyre përkitazi me sensibilizimin e familjeve me fëmijë të cilët lindin në shtëpi.

⁵⁸ Komuna e Ferizajt/Uroševac, Prishtinës/Priština dhe Prizrenit kanë krijuar një zyre për regjistrim në spitalet gjegjëse, duke mundësuar që regjistrimi të bëhet drejtpërdrejtë në spital.

⁵⁹ Intervistë e OSBE-së me ZKBGJ në komunën e Junikut, 2 qershor 2011; intervistë e kryer me ZKGJC në komunën e Fushë Kosovës/Kosovo Polje, 20 qershor 2011.

⁶⁰ Intervistë e OSBE-së me drejtorin komunal të administratës dhe ZKBGJ, 19 qershor 2011.

⁶¹ Përfaqësuesi i komunitetit romë nga komuna e Gračanica/Graçanicës, i cili u intervistua, vërtetoi se disa gra lindin në shtëpi dhe ballafaqohen me pasojat pasuese për nxjerrjen e certifikatave të lindjes.

⁶² Komuna e Ferizajt/Uroševac, Klokot/Kllokotit dhe Novo Brdo/Novobërdës.

⁶³ Nëpërmjet vizitave të rregullta në terren, OSBE-ja vërejti këtë problem me të cilin po ballafaqohen banorët egjiptianë të Kosovës në fshatin Neticë/Netic; një komuniteti që përbëhet nga 70 pjesëtarë, kryesisht gra dhe fëmijë.

⁶⁴ Kompetencat, struktura dhe përbërja e tanishme (shtatë anëtarë, duke përfshirë ZKBGJ) dhe funksionimi i ZKDNJ rregullohet me anë të UA nr. 2011/04 të MAPL-së për ndryshimin dhe plotësimin e UA nr. 2011/01 për themelimin e njësive për të drejtat e njeriut, 20 tetor 2011.

4.5. Tarifat e papërballueshme të regjistrimit

Gjatë intervistave, disa përfaqësues nga komunitetet joshqiptare raportuan se kishin pasur probleme me përballimin e shpenzimeve përkitazi me nxjerrjen e dokumenteve të ndryshme⁶⁵. Anëtarët e këtyre komuniteteve janë veçanërisht të prekura nga varfëria dhe papunësia.⁶⁶

Përderisa letërnjoftimet lëshohen pa pagesë, tarifa prej 10 eurosh zbatohet në rastet e zëvendësimit të tyre (për shkak të humbjes apo dëmtimit), si dhe në rast të ndërrimit të dhënave.⁶⁷ Pasaportat lëshohen për 25 euro (100 euro nëse lëshohen brenda 72 orëve) ndërsa tarifa prej 25 eurove zbatohet për zëvendësim apo vazhdim⁶⁸, kurse çmimet janë më të larta për lëshimin e pasaportave të reja biometrike.⁶⁹ Sipas mendimit të qeverisë, nuk parashihet asnjë përjashtim për shkak se kjo do të perceptohej si një formë e diskriminimit ndaj kategorive që nuk përjashtohen, duke nënvizuar se vetëm dokumenti thelbësor, letërnjoftimi, lëshohet pa pagesë.⁷⁰ Tarifat që zbatohen për nxjerrjen e dokumenteve të gjendjes civile⁷¹ luhaten nga 50 centë deri në 5 euro.⁷² Ndonëse disa komuna përjashtojnë disa kategori të caktuara nga pagesa për dokumentet e gjendjes civile,⁷³ kjo nuk është një praktikë që zbatohet në mbarë Kosovën. Edhe kur kjo ndodhë, identifikimi i kategorive që përjashtohen i nënshtrohet një shkalle të caktuar të lirisë së veprimit dhe nuk përfshinë të gjitha rastet e varfërisë që ekzistojnë në një komunë të caktuar. Në mbarë Kosovën u nënshkruan 26 memorandume të mirëkuptimit (MM) ndërmjet komunave dhe PDCK-ve që mbulojnë lehtësimin e regjistrimit civil dhe përjashtimin nga pagesa. Sidoqoftë, këto dokumente zbatohen vetëm për refugjatët dhe azilkërkuesit, personat në rrezik të mbetjes pa shtetësi, të

⁶⁵ Gjatë intervistave të zhvilluara nga OSBE-ja, bashkëbiseduesit në vijim i theksuan barrierat financiare: përfaqësuesit ashkali të Kosovës në komunat Prishtinë/Priştina dhe Lipjan/Lipljan; përfaqësuesi romë i Kosovës në komunën e Gjakovës/Đakovica; përfaqësuesit romë dhe ashkali të Kosovës nga komuna e Ferizajt/Uroševac; përfaqësuesit egjiptianë dhe boshnjakë të Kosovës në komunën e Istogut/Istok; përfaqësuesit romë, egjiptianë dhe serbë të Kosovës në komunën e Klinës/Klina; përfaqësuesit serb dhe malazez të Kosovës në komunë e Deçanit/Dečane.

⁶⁶ Egjiptianët, romët dhe ashkalitë e Kosovës e kanë shkallën më të lartë të përjashtimit nga faktorët e tregut me 40,6 për qind dhe përjetojnë shkallë më të lartë të papunësisë sesa mesatarja e Kosovës (58 për qind kundrejt 45 për qind). Shih faqen 42 të *Raportit për Zhvillimin Njerëzor* të Programit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, fusnota 48 më sipër.

⁶⁷ UA i MPB-së nr. 19/2008 për procedurat e aplikimit për letërnjoftim, për letërnjoftim të humbur/dëmtuar, për ndërrim të dhënave dhe për ripërtëritjen e të dhënave të letërnjoftimit, tetor 2008.

⁶⁸ Tarifa arrin shumën prej 15 eurosh për pasaportat e lëshuar për fëmijët (deri në moshën 3 vjeçare) dhe 20 eurosh për pasaportat që u lëshohen parashtruesve nën moshën 18 vjeçare (vendimi i MPB-së nr. 140 për tarifën, 21 korrik 2008).

⁶⁹ Lëshimi i një pasaporte biometrike kushton 30 euro, ndërsa 35 euro paguhen për zëvendësim të dokumentit apo ripërtëritje të dhënave. Shih ueb faqen e MPB-së: “Ministri Bajram Rexhepi mori vendim për caktimin e tarifave të çmimeve për pasaportat biometrike”, 6 tetor 2011. <http://www.mpb-ks.org/?page=2,46,785> (qasur më 28 shkurt 2012).

⁷⁰ Shih fusnotën 32 më sipër.

⁷¹ Në pajtim me nenin 16 të Ligjit nr. 03/L-049 për financat e pushtetit lokal, i datës 15 qershor 2008, kuvendet komunale janë të autorizuar që të përkufizojnë shkallën dhe llojin e taksave që zbatohen për shërbimet e tyre të regjistrimit të gjendjes civile.

⁷² ZKGJC në mbarë Kosovën raportuan se zbatojnë një taksë prej një 1 eurove për nxjerrjen e certifikatës së lindjes. Taksat për certifikatat e martesës luhaten nga 1 deri në 2 euro, ndërsa certifikata e vdekjes kushton nga 1 deri në 5 euro (përjashtim të vetëm përbën komuna e Suharekës/Suva Reka, ku ky dokument lëshohet pa pagesë).

⁷³ Komunat Deçan/Dečane, Dragash/Dragaš, Istog/Istok, Klinë/Klina, Malishevë/Mališevo, Pejë/Peć, Prishtinë/Priştina dhe Shtime/Štimlje raportuan të kenë përjashtuar një apo disa nga kategoritë në vijim: përfuturit e skemës së ndihmës sociale, pensionistët, studentët dhe nxënësit, familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës.

kthyerit dhe personat e zhvendosur⁷⁴, si edhe përcaktojnë që parashtruesit duhet të aplikojnë nëpërmjet PDCK-së e cila i mbulon taksat e tyre. Kjo ka rezultuar me huti tek komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë të Kosovës në komunën e Mitrovicës/Mitrovica dhe atë të Podujevës/Podujevo, të cilët, për shembull, kanë pritur që të përjashtohen nga pagesa por nuk ishin përjashtuar. Për më tepër, në disa komuna⁷⁵ MM-të asnjëherë nuk u zbatuan në praktikë për shkak se zyrtarët komunalë e konsideruan atë si diskriminues ndaj kategorive tjera të njerëzve.⁷⁶

Në nivel qendror, MAPL-ja nuk vazhdoi në vitin 2011 me praktikën e shpalljes së muajit të regjistrimit pa pagesë⁷⁷ për shkak se ishte e mendimit se romëve, ashkalive dhe egjiptianëve të Kosovës, si dhe serbëve të Kosovës asnjëherë nuk u mohohet regjistrimi edhe kur nuk janë në gjendje që të paguajnë taksat.⁷⁸

4.6. Udhëzimet dhe procedurat joadekuate për kërkesat e padokumentuara

Prodhimi i dokumentacionit që nevojitet gjatë procesit të regjistrimit civil është një nga sfidat kryesore për parashtruesit e kërkesave. Pas konfliktit të vitit 1999 në Kosovë, shumica dërmuese e librave të gjendjes civile u dëmtuan, shkatërruan apo mbetën jashtë Kosovës.⁷⁹ Mungesa e qasjes në librat e gjendjes civile para vitit 1999 shkakton probleme në procesin e vërtetimit të identitetit të banorëve të Kosovës. Nxjerja e dokumentacionit është edhe më sfidues për ato komunitete nomade apo kryesisht të marginalizuara, të tilla si romët, ashkalitë dhe egjiptianët e Kosovës, të cilat shpeshherë nuk kanë asnjë dokumentacion për shkak se edhe prindërit e tyre nuk janë të regjistruar apo lindin jashtë sistemit shëndetësor.

Për të lehtësuar procesin e regjistrimit, legjislacioni lejon pak fleksibilitet, për shembull përdorimin e “dokumenteve tjera” si dëshmi për vërtetimin e identitetit dhe të së drejtës së parashtruesit, si dhe mundësinë e përdorimit të deklaratave të dëshmitarëve për të mbledhur dëshmi për faktet gjegjëse.⁸⁰ Mungesa e një drejtimi të qartë dhe mospasja e udhëzimeve zyrtare me shkrim për procedurën e pranimi të deklaratës nga dëshmitarët, dhe kushtet sipas

⁷⁴ Këto janë kategoritë që i zgjojnë interes KLROKB/PDCK, siç u raportua nga drejtori rajonal i PDCK në rajonin e Prishtinës/Priština gjatë intervistës që u zhvillua më 20 qershor 2011 në lokalet e OSBE-së. Shih gjithashtu Ekipin për Kosovë të OKB-së – KLROKB në <http://www.unkt.org/?cid=2,93> (qasur më 28 shkurt 2012). Gjatë intervistës së njëjtë, OSBE-ja u njoftua që, me nismën e komunës së Gračanica/Gračanicës, MM e fundit përfshin gjithashtu referime të veçanta ndaj personave të zhvendosur brenda vendit, serbë, romë, ashkali dhe egjiptianë të Kosovës, gjë që mund të merret si shembull për komunat e tjera.

⁷⁵ Komunat Gjakovë/Đakovica, Istog/Istok, Klinë/Klina dhe Pejë/Peć.

⁷⁶ Intervistë e OSBE-së me drejtorin rajonal të PDCK në rajonin e Pejës/Peć, 7 qershor 2011, lokalet e PDCK.

⁷⁷ Përkundër dështimit të MAPL-së që zyrtarisht ta shpallë atë, u raportua se komunat e Deçanit/Dečane, Kamenicës/Kamenica, Mitrovicës/Mitrovica, Obiliqit/Obilić dhe Podujevës/Podujevo zbatuan muajin e regjistrimit pa pagesë edhe në vitin 2011.

⁷⁸ Intervistë e zhvilluar nga OSBE-ja me koordinatoren e të drejtave të njeriut në kuadër të MAPL-së, 10 gusht 2011, hapësirat e MAPL-së. Në një azhurnim të dhënë më 12 korrik 2012, i njëjti bashkëbisedues ka raportuar që sipas MAPL-së të gjitha komunat tashmë rregullisht kanë ofruar regjistrim pa pagesë.

⁷⁹ Në kuadër të dialogut Beograd – Prishtinë/Priština të udhëhequr nga BE-ja, në korrik të vitit 2011 të dyja palët arritën marrëveshjen për librat e regjistrimit civil. Me lehtësimin e Misionit të BE për sundim të ligjit (EULEX), procesi i konsolidimit të librave të regjistrimit në Kosovë përfshinë skanimin, kopjimin dhe vërtetimin e të gjithë librave origjinale të regjistrimit civil në dispozicion (më shumë 14,000). Më pas, nga ARC pritet që të konsolidojë të dhënat në mënyrë që të mundësojë një regjistër të besueshëm të gjendjes civile në Kosovë. Shih deklaratën për shtyp të BE-së, *Dialogu i lehtësuar nga BE-ja; tri marrëveshjet*, Bruksel, 2 korrik 2011. http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/docs/pressdata/EN/foraff/123383.pdf (qasur më 28 shkurt 2012).

⁸⁰ Shih fusnotën 27 më sipër.

së cilave mund të pranohen “dokumentet tjera”, ka çuar në zbatim jo të njëtrajtshëm të procedurave, posaçërisht në rastet e lindjeve në shtëpi, regjistrimit të vonuar apo regjistrimit të serishëm.⁸¹

Brenda fushëveprimit të këtij Raporti, OSBE-ja ka hulumtuar nivelin e zbatimit të masave të fleksibilitetit nëpër komuna, si deklaratat e dëshmitarëve dhe “dokumente tjera”. Gjetjet e OSBE-së konfirmuan që, kur përballen me raste të ndërlikuara të aplikuesve të padokumentuar, si dhe në mungesë të udhëzimeve të qarta⁸², komunat kanë qasje të ndryshme në zbatimin e legjislacionit përkatës, si dhe kanë kërkesa të ndryshme për sigurimin e dokumenteve të caktuara. Për shembull, në rastet e personave që nuk kanë dokumente, disa komuna kanë më shumë vullnet sesa tjerat që të mbështeten në dëshmitarët kur vie puna tek lëshimi i certifikatave të lindjes apo të banimit. Gjithashtu, komuna të ndryshme kanë raportuar që kërkojnë dokumente të ndryshme për lëshimin e të njëjtave certifikata.⁸³ Në komunat si Gjilani/Gnjilane dhe Vitia/Vitina, personat e zhvendosur kanë raportuar që janë obliguar të paraqesin marrëveshje të qiramarrjes të vërtetuara në gjykatë për shtëpitë ku jetojnë, që përbën edhe më shumë shpenzime financiare gjatë procesit të regjistrimit civil (pagesa e një avokati për të përgatitur marrëveshjen e qiramarrjes dhe tarifat e vërtetimit në gjykatë).

Një brengë specifike është theksuar nga dy çifte serbësh të Kosovës të intervistuar, të cilët raportuan që dokumentet personale, si certifikatat e martesës që lëshohen nga institucionet serbe, nuk njiheshin nga zyrat e regjistrimit civil. Si pasojë, zyrat e regjistrimit civil në Kosovë nuk e shënonin ndryshimin e gjendjes martesore, duke i lënë aplikantët me mbiemër të vajzërisë në gjitha dokumentet e Kosovës.⁸⁴

Mungesa e udhëzimeve të qarta nga institucionet e nivelit qendror, si dhe mungesa e trajnimeve adekuate për zyrtarët e regjistrimit shpesh çojnë në dhënie të informatave kundërthënëse për publikun, me rrezikun e largimit të publikut nga institucionet. Shembujt janë dhënë nga serbët dhe romët në komunën e Klokot/Klllokotit si dhe komunitetet rom dhe ashkali në komunën e Obiliqit/Obilić, të cilët kanë raportuar të jenë dekurajuar dhe hutuar sepse marrin udhëzime kundërthënëse, si dhe iu kërkohet nga punëtorët e ndryshëm të të njëjtës zyrë komunale që të parashtrojnë lloje të ndryshme të dokumenteve. Të intervistuarit kanë theksuar perceptimin e tyre që zyrtarët e regjistrimit civil punojnë në lirinë e tyre, si dhe perceptohen të marrin vendime arbitrare.

⁸¹ Procedura e regjistrimit të vonuar zbatohet në rastet kur një lindje nuk raportohet brenda afatit 30 ditor, siç përcaktohet me Ligjin për regjistrat e gjendjes civile, fusnota 13 më sipër, neni 16. Në rastet e tilla, regjistrimi kryhet me anë të një vendimi për regjistrim të vonuar që lëshohet nga ZKGJC gjegjëse. Në anën tjetër, procedura e regjistrimit të serishëm bazohet në UA nr. 2006/7 për rindërtimin e regjistrimit të gjendjes civile, 2 qershor 2006. Përderisa i procedon rastet e regjistrimit të lindjes, ZKGJC shpeshherë nuk bën dallimin ndërmjet procedurës për regjistrim të vonuar dhe të asaj për regjistrim të serishëm. Shih Raporti i Byrosë për popullsi, refugjatë dhe migrim i UNHCR-së janar – dhjetor 2007, <http://www.crpkosovo.org/Reports.aspx> (qasur më 28 shkurt 2012).

⁸² Drejtori komunal i administratës së përgjithshme në komunën e Gjilanit/Gnjilane, ZKRC-të në komunën e Han-Elezit/Đeneral Janković, Kaçanikut/Kaçanik dhe Vitisë/Vitina kanë theksuar vështirësitë në zbatim të legjislacionit, si dhe mungesën e përgjithshme të udhëzimeve apo orientimeve unike nga niveli qendror.

⁸³ Për shembull, në komunën e Mitrovicës/Mitrovica, për të nxjerrë një certifikatë banimi, mund të merren dy dëshmitarë me letërnjoftime të Kosovës, derisa në komunën e Vushtrrisë/Vučitrn duhet të paraqitet një faturë e energjisë elektrike apo e tatimeve.

⁸⁴ Zyrat e regjistrimit civil në Kosovë i njohin dokumentet e lëshuara nga institucionet e Serbisë, por nuk i njohin certifikatat e lëshuara nga institucionet që udhëhiqen nga Serbia në Kosovë. Kjo i prek veçanërisht serbët dhe romët e Kosovës.

Për të lehtësuar zgjidhjen e rasteve të ndërlikuara të gjendjes civile të personave të padokumentuar, 11 komuna⁸⁵ kanë raportuar ekzistimin e paneleve/bordeve komunale që kanë për detyrë të bëjnë hulumtime në terren për të grumbulluar dhe vërtetuar informatat e aplikuesve. Mirëpo, shumica e komunave nuk kanë themeluar mekanizma të tillë, duke pretenduar që nuk janë të domosdoshme.⁸⁶

4.7. Distanca, brengat e sigurisë, si dhe kushtëzimi i lëshimit të dokumenteve me pagesë të tatimeve pronësore

Mes anëtarëve të intervistuar të komuniteteve, shpenzimet e udhëtimit janë raportuar të jenë pengesë nga ata që duhet të udhëtojnë për të shkuar tek vendi i tyre i origjinës, pasi që certifikatat e lindjes lëshohen në vendin ku është bërë lindja (e jo në vendbanimin e aplikantit). Disa nga të njëjtat të intervistuar gjithashtu kanë shprehur ngurrimin e tyre që të udhëtojnë për të nxjerrë certifikatat e lindjes për shkak të brengave të sigurisë⁸⁷. Nga një aspekt tjetër, OSBE-ja ka vërejtur që ndonëse numri i komunave që i obligojnë qytetarët për të paguar tatimet në pronë për të lëshuar dokumentet e gjendjes civile është duke u zvogëluar, kjo praktikë është *de facto* ende në zbatim në tri komuna⁸⁸, në kundërshtim me kornizën ligjore⁸⁹. Në këtë kuptim, OSBE-ja ka vazhduar ta theksojë këtë brengë tek komunat, meqë një praktikë e tillë nuk përputhet me kornizën ligjore, dhe duke privuar qasjen në këto dokumente, ato shkelin standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

5. PËRFUNDIME

Ekzistojnë disa dokumente ligjore dhe politika të cilat i ofrojnë institucioneve të Kosovës kornizën për sigurimin e përfshirjes së të gjitha komuniteteve në shoqëri, përmes masave të veçanta, të orientuara kah lehtësimi dhe përmirësimi i procesit të regjistrimit civil.

OSBE-ja mirëpret bashkëpunimin e hisedarëve lokalë me bashkësinë ndërkombëtare në përmirësim të funksionimit të sistemit të regjistrimit civil, zotimin për përmirësimin e kornizës legislative, si dhe rritjen e numrit të zyrave të regjistrimit civil. Në nivel komunal, zyrtarët e regjistrimit civil si dhe komunat kanë ndërmarrë disa iniciativa dhe kanë bërë vetëdijësim në bashkëpunim me UNHCR-në dhe CRPK-në, dhe kanë liruar disa kategori nga tarifat administrative për lëshimin e dokumenteve. Megjithatë, ndonëse asnjë individ nuk pengohet në mënyrë aktive nga qasja në regjistrim civil, ende ka barriera për regjistrim, të cilat kryesisht prekin grupet më të cënueshme të Kosovës.

⁸⁵ Deçan/Deçane, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Glogovac/Glogovac, Istog/Istok, Kamenicë/Kamenica, Mitrovicë/Mitrovica Obiliq/Obilić, Pejë/Peć, Podujevë/Podujevo, Skenderaj/Srbica, dhe Štrpce/Shtërpce.

⁸⁶ Këto panele/borde komunale themelohen në bazë të vendimeve komunale.

⁸⁷ Në komunën e Rahovecit/Orahovac, serbët e Kosovës të lindur në komunën e Gjakovës/Dakovica kanë raportuar të ngurrojnë të udhëtojnë atje, për shkak të brengave të sigurisë. Të njëjtat brenga të sigurisë janë theksuar edhe nga romët, ashkalitë dhe egjiptianët e komunës së Obiliqit/Obilić, në lidhje me shkuarjen në komunën e Prishtinës/Priština për të nxjerrë dokumente.

⁸⁸ Kjo praktikë është vërejtur në Kamenicë/Kamenica (kushtëzimi i lëshimit të dokumenteve të gjendjes civile, përveç certifikatave të lindjes, martesës dhe vdekjes), Mitrovicë/Mitrovica dhe Ranilug/Ranillug.

⁸⁹ Ligji nr. 03/L-204 mbi Tatimin në Pronë të Paluajtshme, 1 nëntor 2010, neni 18, flet vetëm për ndërprerjen e “shërbimeve komunale për pronën e tatimpaguesve” nëse një tatimpagues nuk paguan tatimet e veta. Pasi shërbimet komunale që mund të ndërpriten janë ekskluzivisht të ndërlidhura me pronën, praktika e kushtëzimit të dokumenteve civile personale me pagesë të tatimeve pronësore nuk është e parashikuar me kornizën legislative.

Numri i zyrave dhe nën-zyrave të regjistrimit civil është rritur në të gjithë Kosovën, por burimet joadekuate financiare, logjistike dhe njerëzore e kufizojnë funksionimin e tyre të mirëfilltë.

Ndonëse institucionet dhe zyrtarët komunalë janë të obliguar të sigurojnë ofrimin e shërbimeve në të gjitha gjuhët zyrtare, komunitetet që janë në pakicë numerike në një komunë të caktuar ende nuk janë në gjendje të komunikojnë në komunat e tyre me zyrtarë të regjistrimit civil dhe të marrin dokumente në gjuhën e tyre, pasi që shërbyesit civil shpesh nuk e flasin gjuhën e tyre. Për më tepër, pjesëtarët analfabetë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian përballen me sfida shtesë në plotësimin korrekt të formularëve për të pasur qasje në regjistrim civil.

Në nivel komunal, institucionet lokale kanë ndërmarrë disa iniciativa për përmirësim të procesit të regjistrimit civil, por nuk kanë pasur vetëdijësimin dhe përafrimin e duhur me komunitetet lokale, ashtu siç kërkohet me kornizën e përgjithshme të politikës. Në vend të kësaj, institucionet vazhdojnë të mbështeten tek UNHCR-ja dhe CRPK-ja për të lehtësuar regjistrimin e të kthyerve dhe komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Derisa korniza ligjore dhe politikat i obligojnë komunat që të adresojnë plotësisht brengat e të drejtave të njeriut që kanë qytetarët e tyre, organet përkatëse komunale, sidomos ZKBGJ-të dhe NjKDNj-të, kanë dështuar të marrin parasysh përhapjen e lindjeve jashtë sistemit shëndetësor në planet e tyre të punës, si dhe të bashkëpunojnë në mënyrë proaktive me OJQ-të për të monitoruar ato raste dhe për të mundësuar regjistrimin e menjëhershëm të foshnjave të porsalindura.

Varfëria dhe papunësia e komplikojnë procesin e regjistrimit edhe më shumë, duke i bërë disa individë që të mos jenë në gjendje të paguajnë tarifat e nevojshme për nxjerrjen e dokumenteve të gjendjes civile. Edhe pse ka komuna që lirojnë disa kategori të popullsisë nga pagesat administrative, kjo nuk është praktikë e konsoliduar në të gjithë Kosovën. Për më tepër, kategoritë e liruarra i nënshtrohen një lloj mase të diskrecionit, si dhe nuk përfshijnë plotësisht të gjitha rastet e të varfërve në komunat e caktuara. Përveç kësaj, MAPL-ja vetëm një herë qysh prej vitit 2009 e ka shpallur një muaj të regjistrimit falas për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, përkundër faktit që kjo parashihet të ndodhë çdo vit në Strategjinë për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, 2009–2015, si dhe Planin e Veprimit të saj.

Mbetet mjaft për t'u bërë në lehtësimin e regjistrimit të aplikuesve të padokumentuar. Pa udhëzime nga institucionet përkatëse të nivelit qendror, qasje të unifikuar dhe trajnime adekuate për t'u përballur me rastet e ndërlikuara të aplikuesve pa dokumente, zyrtarët e regjistrimit civil në komuna janë munduar që të ofrojnë informata të qarta për publikun, si dhe të zbatojnë kriteret konsistente në të vendosurit mbi atë nëse duhen pranuar “dokumente tjera” si dëshmi për vërtetimin e identitetit dhe zotësisë juridike të aplikuesve.

Gjithashtu, brengë e veçantë është praktika e kushtëzimit të lëshimit të dokumenteve të regjistrimit civil me pagesën e tatimeve në pronë *de facto* e pranishme në disa komuna. Kjo praktikë shkel standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe kornizën përkatëse ligjore në Kosovë.

6. REKOMANDIMET

Për institucionet qendrore:

Ministria e Punëve të Brendshme:

- T'i sigurojë zyrtarëve komunalë të regjistrimit civil burime adekuate financiare, logjistike dhe njerëzore për të përmirësuar funksionimin e tyre;
- Të monitorojë zbatimin nga ZKRC-të të obligimeve për ofrimin e komunikimit dhe shërbimeve në gjuhët zyrtare, drejtpërdrejt përmes shërbyesve civilë apo përmes asistencës gjuhësore;
- Të hartojë politika për të siguruar që tarifat e aplikuara për dokumentet personale civile të jenë të përballueshme për pjesëtarët e cenueshëm të popullsisë, ose të hiqen plotësisht; kategoritë që duhen liruar nga pagesat për gjendje civile duhen përcaktuar qartë në nivel qendror, si dhe duhen zbatuar në mënyrë uniforme nga gjitha komunat;
- T'i ofrojnë zyrtarëve të regjistrimit civil udhëzime dhe t'i qartësojnë kushtet në të cilat "dokumentet tjera" mund të pranohen si dëshmi për vërtetimin e identitetit dhe të drejtës së aplikuesve, si pjesë e masave të fleksibilitetit për lehtësimin e regjistrimit civil.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal:

- Të promovojë tarifa të përballueshme duke rikthyer muajin e regjistrimit pa pagesë për çdo vit;
- Të sigurojë trajnime gjithëpërfshirëse për të drejtat e njeriut për t'i rritur kapacitetet e njësive komunale për të drejtat e njeriut për të minimizuar numrin e lindjeve të fëmijëve jashtë sistemit shëndetësor, në pajtim me rekomandimet e parapara me kornizën e politikave.

Për institucionet komunale:

- T'i furnizojnë ZKRC-të me burime adekuate financiare, logjistike dhe njerëzore për të përmirësuar funksionimin e tyre;
- Të monitorojnë zbatimin nga ZKRC-të të obligimeve të tyre për ofrimin e komunikimit dhe shërbimeve në gjuhët zyrtare, drejtpërdrejt përmes shërbyesve civilë apo përmes asistencës gjuhësore;
- Të avancojnë cilësinë e informatave në dispozicion në ZKRC, duke i furnizuar ato me materiale të shkruara që përcaktojnë qartë të gjitha obligimet e parapara me procedura të regjistrimit civil, duke plotësuar informatat verbale që jepen nga nëpunësit;
- Të rrisin integritimin e njësive komunale për të drejtat e njeriut brenda strukturave komunale duke promovuar bashkëpunim me organet tjera përkatëse komunale.

- Të përmbahen nga kushtëzimi i lëshimit të dokumenteve civile me pagesën e tatimeve pronësore.

Për njësitë komunale për të drejta të njeriut:

- Të bashkëpunojnë në mënyrë proaktive me OJQ-të për të organizuar takime me komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian për të zvogëluar numrin e foshnjave të paregjistruara që kanë lindur jashtë sistemit shëndetësor.